

PËR: Komisionin për shqyrtimin e ankesave për nënpunësit e shërbimit publik në Komunën e Malishevës, adresa: Rr. "W.Walker", p.nr., në Malishevë, Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: **DKA-ja**);

CC: Ekrem Kastrati, kryetar i Komunës së Malishevës

NGA: Rasim (Bajram) Morina, i lindur më datë 02.03.1976, me numër personal i identifikimit: 1007890733, me vendlindje: Astraup, K. Malishevë, Republika e Kosovës, e-mail resais@gmail.com, tel: +38349 398-795 (në tekstin e mëtejshëm: **KANDIDATI**).

Duke u bazuar në 125 dhe 126 të Ligjit nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), nenit 74 Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, nenit 82 Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Së Kosovës, si dhe nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, si dhe në përputhje të plotë me udhëzimin juridik të vendimit të atakuar, brenda afatit ligjor, më datë 12 maj 2022, parashtronë këtë:

ANKESË

Lënda: *Kundër vendimit të kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati, nr. 01/660, të datës 27.04.2022.*

Të nderuar Z/Znj,

1. Duke u bazuar në vendimin e publikuar nga Web faqaja zyrtare e komunës së Malishevës, saktësisht vendimin nr. 01/660, të datës 27.04.2022, të nxjerrur nga kryetari i komunës, z. Ekrem Kastrati, vendim i publikuar pas orarit të punës, në ora 17:55, në ditën e 45 pas mbylljes së konkursit është bërë shkelje ligjore, ku është fakt notor që orari zyrtarë në institucionet publike, në administratë mbaron puna në ora 16:00, publikimi në këtë kohë me apo pa qëllim e ngrit dyshimin e bazuar për lojra të ndryshme për të cilat tani më janë të evidentuara dhe do t'i sqarojmë në vijim.

1.1. PROVË: Vendimin nr. 01/660, të datës 27.04.2022, të nxjerrur nga kryetari i komunës së Malishevës z. Ekrem Kastrati.

Prandaj, duke u bazuar në arsyet më poshtme parashtrorë ankesë:

- I. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës së rekrutimit;
 - II. për shkak të shkeljes së legjislacioneve në fuqi;
 - III. për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike;
2. Është mirë të përmbledhim një historik të shkurtër që nga momenti i publikimit të konkursit nr. 11/81, të datës 28.01.2022, ecurinë e tij, e deri tek nxjerrja e një vendimi jo legal, të padrejtë dhe të pabazuar e në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat janë në fuqi në Republikën e Kosovës. Në Udhëzim Administrativ (MASH) nr. 151/2020, ku në nenin 5 Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidati/ja për të marrë pjesë në konkurs, parag. 1, përmenden se cilat kushtet duhet të përmbushin nga kandidatë

ku edhe janë të renditura sipas rëndësisë ku në nën parag. 1.2.1 Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej: 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit univesristar); nënparag. 1.2.2 Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/ 5 vite të shkollimit universitar), po ashtu paragrafi 1.7 i po këti nenit (5) e thekson se kandidati duhet të posedojë dokumentet e cekura në këtë nen, te cilat kanë qënë te plota nga ana e kandidatit si dhe nga vetë DKA-ja, përmenden të njëjtat, te pjesa kushtet dhe shkathësit të kërkuara në bazë të konkursit të publikuar.

2.1. PROVË: Konkursi nr. 11/81, të datës 28.01.2022, i publikuar nga DKA-ja, si dhe UA (MASH) nr.151/2020.

2.1.1. Dispozitat ligjore apo më mirë të themi kriteret ligjore të kërkuara në konkurs si dhe në udhëzimin administrativ, i përshtaten në tërësi kualifikimeve të mia si kandidat për pozitën nr. 6 për Drejtor i SHFMU "Ganimete Terbeshi", Astrazup. Në vazhdim do të bëjë një përmbledhje të përgjithshme të begrandit/ kualifikimeve profesionale të parashtruesit të ankesës si kandidat, e që të njëjtat i keni pasur të prezantuar që nga momenti i aplikimit, intervistimit, e të njëjtat fatkeqësisht nuk i keni pasur për bazë në momentin e nxjerrjes së vendimit të ankimuar, dhe ato janë si në vijim:

2.1.2. Nëse i analizojmë formularët e intervistës dhe i shohim fushat në të cilat kemi pasur të japim përgjigje të gjitha korospodojnë me përgatitjet e mia profesionale, respektivisht Formulari (C), njohuritë e përgjithëshme të sistemit të arsimit, si parashtrues i ankesës jam i kualifikuar në Master, Udhëheqje në Arsim, në U.P "Hasan Prishtina", në Prishtinë, pastaj njohuritë dhe përvojat në zbatimin e kurrikules, trajner kurrikule, që nga fillimi deri më sot (i cili është fakt notor dhe një gjë të tillë e kanë të njohur secili anëtarë i komisionit përzgjedhës e besa edhe vetë kryetari), përvojat paraprake në mentorimin e kolegëve, kam mentoruar të gjithë mësimdhënsit e komunës së Malishevës në Fushën e Gjuhë dhe Komunikim, si dhe një grup në komunën e Gjakovës, kam mentoruar kolegët në shkollën ku punoj, si fasilitues i Vlerësimit Formativ.

2.1.3. Përvojat paraprake në menaxhimin e projekteve, kam përfituar projekte në shkollën ku punoj, i keni të dokumentuar në shkollë.

2.1.3.1. PROVË: Të gjitha dokumentet të cekura më lartë jam të gatshëm ti prezantoj edhe përkundër faktit se për një gjë të tillë vetëm se jeni në dijeni të gjithë e veçanarisht DKA-ja të cilat i kam në CV

2.1.3.2. Shtrohet pyetja logjike: *Si është e mundur të sfidohem në këto fusha nga një kandidat që nuk ka qënë pjesë e zhvillimit profesional në asnjë në këto pika?*

2.1.4. Pjesa tjetër e pyetësorit të Plani Zhvillimor të Shkollës,(PZSHS) në secilin projekt që kemi përfituar si shkollë kam qënë pjesëmarrës i hartimit të PZSHS së, kam pasur lëndë Planin Zhvillimor në studimet Master, kam hartuar PZSHS në trajnimin për zhvillimin e kapacitetetve të drejtorëve, kam qënë pjesë e hartimit të Strategjive të arsimit, të gjitha mundem me i faktografu me dëshmi

2.1.4.1. Shtrohet pyetja logjike: *Si është e mundur të sfidohem nga një kandidat që nuk ka qënë pjesë e asnjë projekti shkollor?*

2.1.5. Në bazë të arritjes së zhvillimit profesional në krijimin e klimës në shkollë, në integrimin e nxënësve, mësimdhënsve, dhe prindërve kam ndjekur

trajnim me mbi 500 orë(vetëm në këtë drejtim), duke ia shtuar edhe atë të ndermjetësimit, kjo tregon që kam përgatitje të mjaftueshme në integrimin e të gjitha palëve në procesin edukativo arsimor.

2.1.5.1. Shtrohet pyetja logjike: Si është e mundur të sfidohem nga kandidati që nuk ka qenë pjesë e asnjë projekti të tillë apo trajnimi?

2.1.5.1.1. PROVË: Të gjitha dokumentet të cekura më lartë jam të gatshëm ti prezantoj edhe përkundër faktit se për një gjë të tillë vetëm se jeni në dijeni të gjithë e veçanarisht DKA-ja.

Shkeljet ligjore, diskriminimi, zbatimi i gabuar i së drejtës dhe legjislacionit në përgjithësi.

3. Me vendimin e nxjerrur e i cili atakohem janë shkelur parimet bazë të Kushtetutës së Kosovës që definohet qartë në neni 23 Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; neni 24 [Barazia para Ligjit] parag. 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim; parag. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, **mendimeve politike** ose të tjera...
4. Gjatë këtij konkursi nr. 11/81 është vërejtur shkelja tjetër, kryetar i komisionit për intervistim është zgjedhur Enver Mazreku, **me kualifikim jashtë fushës së edukimit dhe arsimit** kjo bie në kundërshtim me:
 - 4.1. Udhëzimin Administrativ (MASH) nr. 151/2020, ku në nenin 6, parag. 7, i cili thotë se: **"Anëtarët e MASHT dhe DKA duhet të kenë së paku një kualifikim të barasvleshëm me kërkesën për kualifikim të kandidatëve për pozitë të drejtorit, (pra njëri anëtar nuk ka as kualifikim arsimor)".** - Fjala; barasvlérsh/ëm (i), -me (e) mbiemër që ka vlerë të barabartë me një tjetër, i njëjtë(fjalor I GJ, SH).
 - 4.2. **Nuk mundet me qenë i barabartë një ekonomist me një Master në Udhëheqje në arsim**, pra ketu kemi shkelje që nga emërimi i komisionit, i cili komision ka qenë në funksion të shërbimeve dhe zbatimit të urdhërave të komunikimeve verbale apo joverbale me ekzekutivin e komunës, dhe KK duke shkelur qëllimisht në tërësi nenin 6 të UA (MASH) nr. 151/2020.
5. Shkelje tjetër është në publikimin e orarit të intervistave të kandidatëve për drejtor, edhe këtë çështje e rregullon me precizitet të lartë UA 151/ 2020.
 - 5.1. Neni 5, parag. 1 nënparag. 1.2.1. kërkohet: Master në Udhëheqje dhe nënparag. 1.2.2 Master profesional, ndërsa Drejtoria e Arsimit dhe Edukimit ka **listuar dhe publikuar emrat e kandidatëve me preferenca politike, ka publikuar pa asnjë kriter**, nuk është përfill as kualifikimi i kandidatëve, as moshja, as renditja sipas alfabetit kjo është bërë me qëllim të diskriminimit tim në mënyrë të tërthortë.
6. Shkeljet e lartëcekura parashihen dhe janë të normuara në Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovë, ku në neni 35 parag. 1 Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore, mësime ndihmësit, asistentët dhe instruktorët zgjidhen përmes një konkursi publik **në bazë të meritës personale, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për arsye reale apo të supozuara** që ka lidhje me gjininë, racën, gjendjen martesore, orientimin seksual,

përkatësinë etnike, nevojat e veçanta, pasurinë, vendin e lindjes, **pikëpamjet politike** ose filozofike apo rrethanat e tjera.

7. Shkelje tjetër që gjatë intervistës nuk është **marrë për bazë fare kualifikimi, nuk është marrë fare për bazë zhvillimi profesional, nuk janë marrë fare për bazë certifikatat e trajnimit, të gjitha këto përgatisin personin të jetë kandidat serioz në intervistë** kjo përcaktohet se: Nuk munden me qenë 330 kredi me 240 kredi, nuk mundet me qenë i barabartë shkollimi Master në Udhëheqje në Arsim, me nivelin Bachelor. Në përgatitjen dhe formimin e kandidatëve gjatë procesit të regrutimit. E që kjo përbën fakt jo kontestues dhe të pa asnjë alternativ tjetër.
8. Është për të ardhur keq se si një vendim i nxjerr nga kryetari z. Kastrati, ka shkelur një varg të dispozitave ligjore duke mos përjashtuar as Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovë, nenin 35 parag. 3, 4 dhe parag. 5 Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxhues ose për mësimdhënës, merren për bazë kushtet, si janë: **arsimimi i secilit kandidat, përvoja, kualifikimet për pozitë dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim,** e që në rastin në fjalë asnjë nga këto kritere nuk është zbatuar.
9. Gjatë intervistës/ emërimit të kandidatit janë shkelur parimet, UA (MASH) 151/2020, respektivisht neni 2 parag. 2.1 **Parimi i ligjëshmërisë dhe depolitizimit,** parag. 2.2 **Parimi i meritës dhe kompetencës,** parag. 2.4. **Parimi i paanshmërisë,** mundësive të barabarta dhe mos diskriminimit e që është një fakt notor që kandidati i zgjedhur është anëtar subjektit politik qeverisës.
 - 9.1. Në bazë të asaj që kanë parë vëzhguesit kanë vlerësuar performancën time në intervistë, edhe këtu **komisioni është treguar i njëanshëm dhe diskriminues duke shkelur** përsëri UA (MASH) përkatësisht nenin 8, paragrafi 4.2. "Vlerësimi bëhet në mënyrë të pavarur nga secili anëtar i komisionit përzgjedhës prej tre anëtarëve që kanë rolin e vlerësuesve në komisionin përzgjedhës;
 - 9.2. Po ashtu në të njëjtin nen në parag. 2.3 Parimi i transparencës, ku pas mbarimit të intervistës, **nuk është bërë poentimi i kandidatëve në prani të përfaqësuesve të prindërve dhe mësimdhënësve.** Është plotësuar vetëm formulari B1, i cili ka vetëm 20 pikë. Ndërsa formularët: (C), (D), dhe (E). Në këta formularë listohen kandidatët në bazë të intervistave. Kryetari i komisionit i ka detyruar përmes vendosjes në lajthim faktik dhe juridik që të nënshkruajnë përfaqësuesit e prindërve dhe mësimdhënësve, **pa u plotësuar lartë.** Kjo tregon që është **thyer parimi i transparencës,** dhe këta përfaqësues nuk e kanë ditur se cili ka qenë kandidati meritor deri në publikimin e vendimit nga kryetari i komunës.
10. Shkelje tjetër është Ligji nr. 03/l-212 i Punës, neni 8 lidhur me neni 5.
11. Këtë gjë diskrimin e ndalon edhe Ligji nr. 05/L -021 për Mbrojtjen nga Diskriminim ku në neni 3 Koncepti i diskriminimit, parag. 1.,2. Neni 4 .1. Llojet e trajtimit të pabarabartë janë si në vijim: parag. 1.1. 1.2.
12. Parashtruesi i kërkesës, më daë 04.05.2022, për qasje në dokumente zyrtare në komunën e Malishevës, me nr. Proto: 03/06, ku edhe **kam pranuar përgjigjen e**

pjesërishme në lidhje me këtë kërkesë, më datë 10.05.2022, është mirë të theksohet se dokumentet e ofruara nga DKA, mungojnë CV dhe aplikacionet së bashku me dokumentet e bashkëlidhura të kandidatëve të tjerë

12.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të cilat na është lejuar qasja, kemi vrejtur një varg të shkeljes e mos përputhjes të të dhënave të rëndësishme për këtë formular. Ashtu që në formularin B1, kolona 2 **“Nota Mesatare gjatë studimeve 4 vjeçare) unë si kandidat nuk jam vlerësuar fare me pikë, edhe pse është obligative që të vlerësohem nga komisioni,** gjithashtu në të njëjtin formular në kolonën 6 (Dëshmi për kontribute në proceset e zhvillimit të arsimit), ku si trajner kurrikule kam kontribuar në këtë drejtim më shumë se 5 vite (të dokumentuara me provat e bashkangjitura), e që gjithashtu ky komision ka qenë i obliguar të poenton me pikë.

12.2. Prandaj, duke u bazuar vetëm në poentimin e këtyre kolonave të cilat qëllimisht janë neglizhuar nga komisioni, **automatikisht më bëjnë kandidatin më meritore dhe fitues të këtij konkursi, sepse kandidati fitues ka 77.83 pikë, ndërsa unë kam 77.50 pikë, që i bije vetëm 0.33 pikë më shumë, pa llogaritur kolonat e përmendura më lartë që nuk jam vlerësuar me pikë.**

13. Në bazë të lartëcekurave, respektivisht atyre që u tha në pikën 9, nën-pika 9.2, 10, 11 dhe 12 të kësaj ankese, dëshirojmë që përmes kësaj ankese ta njoftojmë komisionin e ankesve se përveç **ligjeve të sheklura të natyrës procedurale, e atyre të fushës përkatëse me anë të veprimeve të qëllimshme dhe taktike duke pasur synim të vetëm arritjen e qëllimeve politike, kryesuesi/anëtarët e komisionit kanë konsumuar elementet e veprës penale,** për shkak të përmbushjes së figurës së veprës penale, dhe ato si në vijim:

13.1. Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, i parasheh veprat penale të parapara në nenin 25 paragraf. 2 Lajthimi faktik; nenin 26 paragraf. 3 Lajthimi Juridik; të lidhur me nenin 390 Falsifikim i dokumenteve, nenin 414 paragraf. 1 “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet”. Si dhe nenin 190 paragraf. 1. “Kushdo që për shkak të përkatësisë kombëtare apo etnike, racës, fesë, apo për shkak që nuk i përket ndonjërisë përkatësi, **apo për shkak të bindjeve politike ose bindjeve të tjera,** gjinisë, invaliditetit, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, arsimit, pozitës shoqërore, prejardhjes sociale, gjendjes materiale, apo ndonjë karakteristike tjetër personale, tjetrit ia mohon ose kufizon të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë, ligj ose dispozita të tjera, akte të tjera të përgjithshme ose marrëveshje të ratifikuara ndërkombëtare, apo i jep privilegje apo favore bazuar në këto dallime, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet”. Në bazë të kësaj konstatojmë se përpos komisionit **edhe kryetari i**

komunës me qëllim dhe i vetëdijshëm për veprimet e tij ka keqpërdorur detyrën zyrtare.

14. Duke i evidentuar këto shkelje ligjore ky konkurs është i kurdisur me kandidatin e preferuar, kërkoj nga Komisionin për shqyrtimin e ankesave për nënpunësit e shërbimit publik në Komunën e Malishevës të anulohet vendimin e ankimuar dhe të reflektoj në kërkimin e konkurrencës dhe vlerave edukativo-arsimore. Konkurenca, dija dhe përgatitja profesionale më se shumti i bëjnë nderë drejtorisë përkatëse.

Prandaj, në bazë të lartëcekurave dhe provave të bashkangjitura kërkojë nga komisioni i ankesave që të më aprovoni ankesën time, ashtu që të nxjerrni këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** në tërësi aneksa e parashtruesës Rasim Morina, nga fshati Astrazup, komuna e Malishevës, **SI E BAZUAR;**
- II. ANULOHET** vendimi i kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Ekrem Kastrati, nr. 01/660, të datës 27.04.2022, për emërimin e drejtorit të SHFMU "Ganimete Tërbeshi" në Astrazup, **SI I PALEJUAR.**
- III. MIRATOHET** kërkesa për ri-vlerësimin e kandidatëve dhe shqyrtimin e drejtë të kriterëve profesionale dhe meritokracisë si parim bazë i drejtësisë.
- IV. REKOMANDOHET** të nxjerrret vendim për emërimin e drejtorit të SHFMU "Ganimete Tërbeshi" në Astrazup, **RASIM MORINA.**

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, Ju përshëndes!

Rasim MORINA

Parashtruesi i ankesës/Kandidat

Malishevë, më datë: 12 maj 2022